




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Sejdiu & Qerkini” Sh.P.K. të datës 22.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit” me nr. të prokurimit 616-24-599-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Sejdiu & Qerkini” Sh.P.K. e datës 22.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit” me nr. të prokurimit 616-24-599-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Sejdiu & Qerkini” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Sejdiu & Qerkini” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 22.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit” me nr. të prokurimit 616-24-599-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

**Pretendimi nr. 1** – *“Autoriteti Kontraktues në Dosje të tenderit ka përcaktuar si kusht formën e regjistrimit të operatorit ekonomik që do të shpërblehet me kontratë. Në dosje është kërkuar që operatori duhet të jetë operator i regjistruar si shoqëri e avokatisë në përputhje me Ligjin për Avokatinë, përkatësisht Nenin 30 të Ligjit. Në anën tjetër, dy ofertat më të lira në këtë aktivitet të prokurimit nuk e përmbushin këtë kusht, pasi që të kanë bërë konsorciume me kompani të cilat nuk janë të regjistruara si shoqëri të avokatisë pranë Odës së Avokatëve të Kosovës. Duke marrë parasysh se me dosjen e tenderit është kërkuar që operatori të jetë shoqëri e avokatisë dhe në rast të angazhimit të kapaciteteve shtesë kjo të bëhet me kontratë për angazhim të avokatit nga shoqëria, konsiderojmë se të dy operatorët konkurrent, nuk e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit, pasi që kanë aplikuar në konsorcium me operator që nuk janë shoqëri të avokatëve”.*

**Pretendimi nr. 2** – *“Operatori i rekomanduar për kontratë, referencën e arbitrazhit të dorëzuar nuk e ka në cilësinë e shoqërisë së avokatisë, por të avokatit individual, rrjedhimisht ky shërbim është ofruar para se operatori të jetë i regjistruar si shoqëri e avokatisë pranë Odës së Avokatëve të Kosovës. Prandaj si e tillë nuk është dashur të pranohet nga ana e Autoritetit Kontraktues përkatësisht komisionit për vlerësimin e ofertave. Për më tepër referenca për shërbimet juridike gjyqësore, nuk mund të konsiderohet si punë e ngjashme, për shkak se është lëshuar nga një individ për një rast specifik penal dhe nuk ka të bëjë me shërbime të ngjashme, të tilla siç kërkohen në dosje të tenderit, ku një autoritet kontraktues kërkon shërbime komplekse me numër të madh seancash brenda një kohe të shkurtër”.*

**Sa i përket pretendimit nr. 1** - kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohet ky pretendim ankimor është formuluar në dosjen e tenderit si në vijim:

<b>Të jetë shoqëri e avokatëve konform nenit 27 par. 1 nënpar. 1.3 dhe nenit 30 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë për së paku një (1) vit me të paktën katër (4) avokat me licencë nga Oda e Avokatëve të Kosovës.</b>	<b>Një kopje të vendimit nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Licencat për avokatët.</b> <b>Nëse shoqëria ka angazhuar avokatë shtesë për këtë aktivitet të prokurimit, atëherë duhet të dorëzohen edhe marrëveshjet për angazhim të avokatëve nga Shoqëria.</b>
---	---

Në ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se lideri i grupit të operatorëve ekonomik është shoqëri e avokatëve për më gjatë se një (1) vit dhe ka në dispozicion katër (4) avokatë të licensuar nga OAK. Me këtë rast është dorëzuar një kopje e vendimit nr. 1469-1/22 të datës 19.01.2023 të OAK për formimin e shoqërisë së avokatëve si dhe licensat e katër (4) avokatëve përkatës, prej të cilëve tre (3) janë pjesë e OE “Pro Juris Law Firm” si lider i GOE dhe një (1) avokat tjetër është pjesë e OE “Tahiri & Partners” si anëtar i GOE me të cilin njëkohësisht shoqëria e avokatëve ka lidhur marrëveshje për angazhim sikurse është përcaktuar me dosjen e tenderit. Vlen të theksohet fakti që në dosjen e tenderit është shënuar saktësisht që *“nëse shoqëria ka angazhuar avokatë shtesë për këtë AP, atëherë duhet të dorëzohen edhe marrëveshjet për angazhim të avokatëve nga shoqëria”.* Në rastin konkret tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar edhe një listë me katër (4) avokatë ku njëri prej tyre është edhe me marrëveshje për angazhim sipas dosjes së tenderit por edhe anëtar i GOE sipas marrëveshjes për themelimin e GOE. Në këtë mënyrë është plotësuar në mënyrë të plotë kërkesa e dosjes së tenderit për të cilën po bëhet fjalë ndërsa pretendimi ankimor është në tërësi i pabazuar.

Vlen të shtohet se pretendimi ankimor i parashtruesit në këtë rast është mjaft paradoksal pasi që vet parashtruesi nuk e ka bashkangjitur në ofertë vendimin për themelimin e shoqërisë së avokatëve por ka dorëzuar një vërtetim të evidentuar me nr. 340/21 të lëshuar me datë 22.02.2021. Për më shumë sipas këtij vërtetimi pjesë e shoqërisë së avokatëve janë vetëm dy avokatë të cilët janë A.Q dhe K.S. Pavarësisht kësaj parashtruesi ka bashkangjitur në ofertë edhe licensat e disa avokatëve të tjerë mirëpo nuk ka bashkangjitur edhe kontratat e tyre të punës apo marrëveshjet për angazhim në këtë aktivitet të prokurimit, përmes të cilave do të mund të dëshmohet se avokatët në fjalë janë pjesë e shoqërisë.

**Sa i përket pretendimit nr. 2** – kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohet ky pretendim ankimor është formuluar në dosjen e tenderit si në vijim:

**Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një (1) shërbim të ngjashëm të arbitrazhit vendor ose ndërkombëtar si dhe një (1) shërbim të procedurave gjyqësore në gjykatat e Republikës së Kosovës, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë).**

**Operatori ekonomik duhet të plotësoj një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës t'i bashkangjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve.**

Në ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se është plotësuar lista e kontratave të realizuar sipas aneksit 6 të DT të cilës i është bashkangjitur edhe referencat përkatëse për shërbimet të evidentuara në listë. Ndër të tjera është dorëzuar edhe një referencë nga Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit me datë 28.02.2024. Sa i përket pikës së pretendimit ankimor ku thuhet se kjo referencë është lëshuar për një avokat individualisht dhe jo për shoqërinë e avokatëve. Referenca për të cilën bëhet fjalë është formuluar si në vijim “z. Arbër Krasniqi me nr. reg. 2105/2021 nga shoqëria e avokatëve Pro Juris Law Firm...”. Pra referenca nuk është lëshuar në emër të një avokati individualisht por në emër të shoqërisë së avokatëve që është lider i GOE të rekomanduar për kontratë. Për më tepër avokati të cilit i referohet parashtruesi në fakt është drejtori menaxhues i shoqërisë së avokatëve “Pro Juris Law Firm”. Pra nga cilido këndvështrim qoftë edhe cilido interpretim i mundshëm nga parashtruesi, referenca i përket shoqërisë së avokatëve “Pro Juris Law Firm” që është lider i GOE të rekomanduar për kontratë. Pra pretendimi ankimor si i tillë është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 2 lidhur me kërkesën e dosjes së tenderit për të cilën po bëhet fjalë, vlen të theksohet fakti që parashtruesi ka dorëzuar një listë të kontratave sipas aneksit 6 të DT ku janë evidentuar gjithsej 6 kontrata prej të cilave 2 janë kontrata të prokurimit dhe 4 të tjera janë shërbime të përfaqësimit në arbitrazh. Me këtë rast parashtruesi ka dorëzuar 3 referenca, 1 për kontratën e prokurimit dhe 2 të tjera për shërbime të arbitrazhit. Vlen të theksohet që njëra prej këtyre referencave të arbitrazhit është e datës 05.11.2020 që dmth se është dukshëm më e vjetër se 3 vite para publikimit të njoftimit për kontratë. Sidoqoftë, parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë referencë për shërbim të procedurave gjyqësore në gjykatat e RKS sikurse është kërkuar në DT të cituar si më sipër. Për më tepër as në listën e kontratave nuk është evidentuar asnjë kontratë për shërbim të procedurave gjyqësore në gjykatat e RKS sikurse është kërkuar në DT.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 25.04.2024**



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.